



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



THIRRJE PËR APLIKIM

Drejtoria për Bujqësi

Ftohen të gjithë fermerët e Komunës së Prishtinës se mund të aplikojnë për furnizim me fidan të kulturës së Gojy Berry-it

Kriteret :

- Përkrahen fermerët për mbjellje të sipërfaqes prej 0,25-0,50 ha;
- Përfituesi duhet të jetë banorë si edhe të ketë pronën në territorin e Komunës së Prishtinës;
- Fermerët janë të obliguar që ta bëjnë vet furnizimin me fidanë si edhe mbjelljen e tyre në sipërfaqen e planifikuar;
- Sipërfaqet e planifikuara për mbjellje më së paku tri vite nuk duhet të kenë qenë të mbjellura me kultura konvencionale;
- Rimbursimi i mjeteve nga ana e Komunës për fermerët do të bëhet pas konstatimit se janë përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara, si dhe varësisht nga numri i fidaneve të mbjellura;
- Fermerët duhet të furnizohen me fidane nga entiteti i licencuar për prodhimin, apo tregtimin e bimëve aromatike-mjekuese “Goji Berry” (hibrid).
- Fermerët e zgjedhurë janë të obliguar që të bëjnë analizën e tokës - parcelës që do e mbjellin me Goji berry dhe nëse këto analiza tregojnë se ajo parcelë nuk i plotëson kriteret për kultivimin e kësaj kulture, atëherë përfituesi/ja , do të refuzohet;
- Duhet të investojnë në vendosjen e sistemit të ujitjes pikë – pikë;
- Fermerët do të përkrahen prej 500-1100 fidanë, varësisht nga madhësia e sipërfaqes së mbjellë ;
- Vlera e përkrahjes do të jetë në raport me përfaqen e mbjellë;
- Çmimi i pranueshëm është deri në 5,00 € / fidanë.
- Të gjitha transakcionet-pagesat duhet të realizohen nëpërmes sistemit bankar.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Projekt propozimi me përshkrim të hollësishëm për mbjelljen e fidaneve ,
 - a. përshkrimin e gjendjes në fermë,
 - b. qëllimin e investimeve dhe
 - c. koston e investimeve
- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin i llogarisë bankare;
- Certifikata mbi pronësinë e paluejtshme me afat deri në një vit;
- Kopja e Planit;
- Licencën e entitetit ku është bërë furnizimi me fidanë;
- Raporti i analizës së tokës
- Certifikata e origjinës së fidaneve;
- Certifikata fito-sanitare;
- Fatura si edhe konfirmimi i transaksionit bankar për pagesën e fidaneve
- Numri i regjistrit të fermerit(NIF).

Data e aplikimit prej 15.05.2018 deri më 04.06.2018